



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-022/01-94899/25, më 01 JUL 2025

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 26, paragrafi 26.13 dhe 26.16 i Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë:

V E N D I M

1. Drejtoria e Shërbimeve Publike e Komunës së Prishtinës, pranon dhe shqyrton kërkesat për dhënie e lejeve për shfrytëzimin e hapësirave publike, mirëmbajtjen e sipërfaqeve gjelbëruese, parkingjet dhe hapësirat tjera publike sikurse është përcaktuar në paragrafët 26.13 dhe 26.16 të nenit 26 të Vendimit për organizimin, kompetencat, përgjegjësitë dhe sistematizimin e vendeve të punës së administratës komunale nr. 01-031-13761 i dt. 19.01.2016.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, miratimi përfundimtar i kërkesave do të bëhet nga Kryetari i Kryeqytetit. Drejtoria e Shërbimeve Publike kërkesën për miratim tek Kryetari i Kryeqytetit e përcjellë përmes Zyrës Ligjore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Zyra Ligjore.
4. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Drejtorisë së Shërbimeve Publike;
- Zyrës Ligjore;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

